



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 334, datë 17.09.2020

PËR
CAKTIMIN E SEANCËS DËGJIMORE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË ILD
PËR FILLIMIN E PROCEDIMIT DISIPLINOR NË NGARKIM TË MAGJISTRATIT
{...}, ME DETYRË GJYQATAR NË GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR KORÇË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 138, në pikën 2 dhe 3, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatori i saj, z. Dritan Hallunaj,

VENDOSI:

1. Zgjatjen e afatit për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, për shkak të periudhës së pushimeve vjetore.
2. Caktimin e datës 02.10.2020, si datë e zhvillimit të seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet palëve në procedurën disiplinore Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistratit z. {...}, sipas kërkesave të nenit 138 të Ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR